



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 97/2013
Prishtinë, më 13.03.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N–303

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha – Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Fikrim Damka dhe Hashim Deshishku.

Pjesëmarrës të tjerë: Ruzhdi Shehu, Nijazi Shala dhe Rexhep Bllaca – MTI; Burim Ejupi dhe Dita Dobranja – INDEP; Shefki Kastrati – NDI; Nora Jusufi – KDI dhe Sylejman Blaku - Kosova sot-gazetar.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.02.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut;
4. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin nr.04/L-176 për turizmin;
5. Informatë rreth pjesëmarrjes së delegacionit të Komisionit në seminarin parlamentar: “Politika energjetike e BE-së dhe roli i saj në vendet kandidate”- Bruksel, më 21 shkurt 2013;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.02.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 26.02.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut

Kryetari – Tha se grupi i punës e ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-186.

Kryesuese e grupit të punës është znj. Myzejene Selmani, të cilës pastaj ia dha fjalën për t'i prezantuar amendamentet.

Myzejene Selmani – Meqenëse ky Projektligj është për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut, grupi i punës ka pasur vetëm një takim. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si sponsoruese e projektligjit dhe për të arsyetuar projektligjin në fjalë. Theksoi se grupi i punës gjatë shqyrtimit i ka hartuar 15 amendamente dhe bëri prezantimin e amendamenteve një nga një.

Vërejtjet në projektligj dhe amendamente:

Përfaqësuesit nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, **z.Rexhep Billaca dhe z.Ruzhdi Shehu**, kërkuar që **amendamentet 12, 13 dhe 14**, të fshihen dhe të mbeten ashtu siç është në projektligj tek neni 13,14 dhe 15, sepse gjobat e propozuara për personat fizikë, janë shumë të larta dhe do të kemi probleme në zbatim të ligjit.

Ramiz Kelmendi – Tha se duhet të jetë e definuar qartë se kush është kryerësi i veprës apo shkelësi i ligjit, e jo të dënohet kompania. Dënimet duhet të jenë proporcionale me të ardhurat që realizohen në vend.

Lutfi Zharku – Sqaroi se këtu kanë të bëjnë me persona fizikë, si subjekte biznesore, e jo për persona fizikë që janë të punësuar brenda një kompanie apo biznesi, dhe për këtë arsye, kemi propozuar gjoba të tilla.

Shaip Muja – Propozoi që masa ndëshkuese të mos jetë në ligj, por të mbetet me legjislacion sekondar, pra të rregullohen me akte nënligjore nga ana e Ministrisë. Kuvendi, në bazë të procedurave, në çdo kohë nuk mund të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve me procedura të shpjeta. Meqenëse aktet nënligjore, ministri përkatës mund t'i hartojë shumë shpjegime dhe t'u përshtatën praktikave më të mira për zbatim të ligjeve.

Pas debatit, Komisioni përkrahu propozimin e Ministrisë, që të fshihen të tri amendamentet e propozuara nga grupi i punës.

Pas debatit, më 7 (shtatë) vota për, 1 (një) votë kundër dhe 1 (një) abstenim, Komisioni nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut, i grupit punues, me vërejtjet e deputetëve.*
2. *Raporti t'i procedohet komisioneve të përhershme, sipas procedurës.*

4. Shqyrtimi i Raportit me Propozim-amendamente për Projektligjin nr.04/L-176 për turizmin

Kryetari – Tha se grupi i punës e ka shqyrtuar Projektligjin nr.04/L-176 për turizmin dhe ka hartuar disa amendamente, ndërsa ne si Komision, sot do t'i shqyrtojmë. Theksoi se kryesues i grupit të punës është z.Hashim Deshishku, por sot nuk është i pranishëm në mbledhje. Prezantimin e Raportit me Propozim-amendamente mund ta bëjë z.Lutfi Zharku, që ka qenë anëtarë i grupit të punës, e pastaj fjalën ia dha për t'i prezantuar amendamentet.

Lutfi Zharku – Grupi i punës ka mbajtur një takim dhe ka shqyrtuar këtë projektligj. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si sponsorues të projektligjit dhe për të arsyetuar projektligjin në fjalë, si dhe përfaqësues nga organizata INDEP, që po e mbështesin punën e Komisionit. Theksoi se grupi i punës, gjatë shqyrtimit, i ka hartuar 25 amendamente dhe bëri prezantimin e amendamenteve një nga një.

Vërejtjet në projektligj dhe amendamente:

Sala Berisha – Shala – Kërkoi sqarim në lidhje me amendamentin 23 ku thuhet: “Këshilli duhet të pasqyrojë përbërjen etnike dhe gjinore të shtetit...” Ajo tha se ne e kemi Kushtetutën dhe ligjet tjera dhe s’kemi nevojë të dublifikojmë legjislacionin.

Visar Ymeri –Tha se me Kushtetutë është e paraparë kjo normë, dhe nëse e lejojmë kështu me ligj, atëherë kemi për ta ngulfatur ose ta bëjmë jofunksional këtë Këshill, duke kërkuar persona nga etnitë në vend dhe në aspektin gjinor.

Biserka Kostiq – Tha se e kam propozuar, sepse nuk po respektohet as Kushtetuta, e as ligjet në fuqi, kur kemi këso rastesh, siç është tani ky Këshill dhe kemi diskriminim në këtë fushë, në aspektin etnik dhe gjinor.

Myzejene Selmani – Propozoi që pjesa e parë e **amendamentit 23** të jetë: “Këshilli do të përbehet nga:”, sepse s’kemi nevojë të bëjmë dublifikim të legjislacionit.

Propozimi i znj. Selmani u përkrah nga Komisioni me shumicë votash.

Lutfi Zharku – Kërkoi që t'i jepet fjala përfaqësuesit të INDEP-së, për të dhënë koment në lidhje me **nenin 6**, sa i përket çështjes se a duhet bizneset që merren me turizëm, të jenë të obliguara të regjistrohen në njësinë përkatëse në Ministri apo të jetë vullnetar, siç është në projektligj. Ky debat ka zgjatur shumë edhe në grupin e punës dhe kemi vendosur të diskutojmë së bashku në Komision.

Burim Ejupi (INDEP – OJQ) – Tha se në të gjitha vendet përreth, por edhe në vendet e BE-së, bizneset që merren me turizëm, janë të obliguara të regjistrohen në njësinë përkatëse për turizëm në Ministri, sepse do të kenë përfitime dhe lehtësira, e jo siç është propozuar nga Ministria, pra që të jetë vullnetar.

Përfaqësuesit nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, **z.Rexhep Bllaca dhe Njazi Shala**, thanë se kjo është bërë në përputhje me programin e Qeverisë për heqjen e barrierave për biznese, për t'u krijuar qasje më të mirë, e jo t'i obligojmë që t'u futen burokracive të ndryshme.

Komisioni u pajtua që të mos bëhet amendament i veçantë dhe këtë çështje ta shikojë Komisioni përkatës për Integritet Evropian, pasi që është edhe në kompetencë të tyre.

Rexhep Bllaca (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë) – Propozoi që edhe **amendamenti 25**, të fshihet dhe të mbetet sikurse në projektligj, që me këtë ligj të shfuqizohen dy ligje, sepse nuk është në kundërshtim me rregullat e hartimit të legjislacionit.

Sala Berisha – Shala – Tha se nuk kemi pasur një praktikë të tillë, dhe pasi që stafi i komisionit ka këshilluar të hartohet ky amendament, atëherë duhet të kërkojmë sqarime shtesë se si të veprohet në këto raste.

Komisioni u pajtua që të mos fshihet amendamenti 25 dhe këtë çështje ta shikojë Komisioni përkatës për Legjislacion, pasi që është në kompetencë të tij.

Pas debatit, me 7 (shtatë) vota për, dhe 2 (dy) abstenime, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me amendamente të Projektligjit nr.04/L-176 për turizmin, i grupit të punës, me vërejtjet e deputetëve.*
- 2. Raporti t'u procedohet Komisioneve të përhershme, sipas procedurës.*

5. Informatë rreth pjesëmarrjes së delegacionit të Komisionit në seminarin parlamentar: “Politika energjetike e BE-së dhe roli i saj në vendet candidate” - Bruksel, më 21 shkurt 2013

Kryetari – Një delegacion nga Komisioni, i përbërë nga dy anëtarë, z.Hashim Deshishku dhe Visar Ymeri, kanë qenë pjesëmarrjes në seminarin parlamentar: “Politika energjetike e BE-së dhe roli i saj në vendet candidate, që është mbajtur në Bruksel, më 21 shkurt 2013. Gjithashtu, është përgatitur një informatë e shkurtër rreth këtij seminari.

Visar Ymeri – I njoftoi anëtarët e Komisionit në vija të përgjithshme lidhur me pjesëmarrjen e delegacionit nga Komisioni. Ai tha se ideja e organizimit të seminarit ka qenë që të gjinden rrugët e bashkëpunimit në fushën e energjisë, që më pas politikat e kësaj fushe të unifikohen. Ai tha që, përveç përfaqësuesve politikë, në këtë seminar ka pasur pjesëmarrës edhe nga shoqëria civile dhe ekspertë nga fusha e energjetikës.

Komisioni, pas debatit, nxori këtë

Përfundim

Të informohet Kuvendi rreth pjesëmarrjes së delegacionit të Komisionit në seminarin parlamentar: “Politika energjetike e BE-së dhe roli i saj në vendet candidate” - Bruksel, më 21 shkurt 2013.

6. Të ndryshme Çështje vijuese

Sala Berisha – Shala - I njoftoi anëtarët e Komisionit se ka marrë pjesë në një konferencë në Bruksel, më 7- 8 mars 2013, me temën: “Energjia e ripërtëritshme”. Ajo theksoi se organizimi i kësaj konferencë ka qenë i karakterit global, ku të pranishëm kanë qenë shumë delegacione nga e

gjithë bota dhe kanë prezantuar opinionet e tyre dhe të vendeve të tyre, në lidhje me energjinë e ripërtëritshme.

Shaip Muja – Tha se duhet të jemi të kujdesshëm në lidhje me energjinë dhe energjinë e ripërtëritshme në veçanti, sepse ne si vend kemi resurse të mëdha, prandaj si legjislativ, duhet të shikojmë kontributin tonë në këtë drejtim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit